



Në bazë të vendimit III.Nr.313-70,të datës 21.04.2018 të lëshuar nga Këshilli Komunal i Komunës së Preshevës, Komisioni për ndarjen e mjeteve stimuluese për zhvillimin e ndermarrësisë lokale në Komunën e Preshevës, shpallë

## **THIRJE PUBLIKE**

### **Për pjesëmarrje në trajnim për fillimin/avancimin e biznesit dhe ndarjen e mjeteve të pakthyeshme në sferën e ndërmarrësisë së të rinjëve dhe grave, në kuadër të projektit për mbështetje të zhvillimit të sektorit privat në Komunën e Preshevës për vitin 2018**

Projektin për mbështetje të zhvillimit të sektorit privat në komunën e Preshevës e zbaton komuna e Preshevës në bashkëpunim me agjencionin e akredituar për zhvillim regional nga Leskovci, Qendrën për zhvillim të Rrethit të Jabllanicës dhe Pçinjës. Mjetet për realizimin e këtij projektit janë të përcaktuara sipas vendimit të buxhetit programorë të Komunës së Preshevës për vitin 2018, në Programin 1501-0003, funksioni 411, numri rendrorë 49, klasifikimi ekonomik 454 në shumë prej 10.000.000,00 dinarë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është avancimi i zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrësisë në përgjithësi, rritjen e shitjes, avancimin e eksportit, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Përmes ofrimit të ndihmës jofinanciare dhe financiare, ky program do të mbështesë zhvillimin e ndërmarrësisë së të rinjëve dhe grave, si dhe ndërmarrjet ekzistuese nëpërmjet:

- edukimit për fillimin dhe udhëheqjen e biznesit, në formë të trajnimit për fillimin dhe avancimin e biznesit,
- garës për biznes planin më të mirë,
- ndihmës së pakthyeshme për finasimin e biznes planeve më të mira,
- trajnimit, këshillimit dhe mentorimit për bizneset / ndërmarrjet e posa formuara dhe ekzistuese.

### **Kushtet për pjesëmarrje në programin për fazën e trajnimeve për fillimin e biznesit**

Të drejtë për pjesëmarrje kanë kandidatët që i plotësojnë kushtet si në vijim:

### **Grupi i I**

#### **Të rinjtë<sup>1</sup> dhe gratë:**

- që kanë ide për ndërmarrësi dhe dëshirë të fillojnë punë;
- që nuk kanë të regjistruar biznes të vetin,
- që kanë vendqëndrim në territorin e komunës së Preshevës,

- që nuk janë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pronës.

<sup>1</sup> Të rinjtë definoohen si meshkujt si femrat të cilët në momentin e shpalljes së Thirrjes publike kanë moshën 18- 30 vite.

### **Të rinjtë dhe gratë- pronarë të ndërmarrjeve mikro dhe ndërmarrësit:**

- Të cilët posedojnë shumicën e pronësisë së ndërmarrjeve mikro ose janë themelues të punëtorive ndërmarrëse,
- Të cilët kanë vendqëndrim në territorin e Komunës së Preshevës,
- Të cilët dëshirojnë të avancojnë biznesin e tyre, ndërsa kanë regjistruar veprimtarinë e tyre në dy vitet e fundit, gjegjësisht në momentin e shpalljes së thirrjes publike nuk punojnë më gjatë se dy vite,
- Të cilët nuk janë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë, si dhe shoqëritë ekonomike në pronësi të tyre, nuk janë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë.

## **Grupi i II**

### **Pronarët e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrësit:**

- Të cilët posedojnë shumicën e pronësisë së mikrondërmarrjeve ose themelues tëveprimtarive sipërmarrëse;
- Të cilët kanë vendqëndrim në teritorin e komunës Preshevë;
- Të cilët nuk janë të dënuar për vepër penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë, si dhe shoqërit ekonomike në pronësi të tyre nuk janë të dënuar për vepra penale kundër ekonomisë dhe vepra penale kundër pasurisë.

### **Dokumentacioni i duhur për konkurim:**

## **Grupi i I**

- Formulari i aplikimit për pjesëmarrje në trajnim për fillimin/avansimin e biznesit (formulari 1),
- Deklarata mbi saktësinë e shënimeve të paraqitura (formulari 1a),
- Kopja e letërnjoftimit (për personat e papunësuar),
- Ekstrakt nga APR (vetëm për kompanitë/ndërmarrjet ekzistuese).

## **Grupi i II**

- Formulari i aplikimit për pjesëmarrje në trajnimin për fillimin/avansimin e biznesit (formulari 2),
- Deklarata mbi saktësin e të dhënave të paraqitura (formulari 2a),
- Ekstrakt nga APR-a.

Përmes projektit është paraparë që kandidatët më të mirë të ranguar, të vijojnë trajnimin për fillimin/avansimin e biznesit që përbëhet prej dy moduleve, siç janë: trajnimi për fillestarët në ndërmarrësi dhe përgaditja e biznes planit, si dhe bashkëpunimi me bankat.

**Të drejtë në pjesëmarrje në Program, në fazën e ndarjes së mjeteve të pakthyeshme biznes planeve më të mira, kanë ata kandidatë të cilët me sukses kanë vijuar trajnimin për fillimin/avansimin e biznesit dhe kanë përpiluar biznes planin.**

Prioritet gjatë ndarjes së mjeteve të pakthyeshme do të kenë të rinjtë dhe gratë (që kanë ide biznesi), pronarë/re të mikro ndërmarrjeve dhe ndërmarrësit, si dhe pronarët e mikro ndërmarrjeve dhe ndërmarrësit, **të cilët nuk kanë qenë përfitues të mjeteve të pakthyeshme të ndara nga Komuna e Preshevës, në dy vitet e fundit.** Kandidatët tjerë potencial do të merren në shqyrtim, nëse në kuadër të grupit prioritarë nuk arrihet numri i parashikuar i shfrytëzuesve të mjeteve të pakthyeshme.

Pas realizimit të garës për biznes planin më të mirë, biznes planet më të mira do të kualifikohen për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme. Kandidatët janë të obliguar që përmes biznes planin të zhvillojnë idenë e biznesit, me të cilën kanë kandiduar në fazën e parë të Programit.

Kusht për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme është regjistrimi i biznesit në Agjencinë e regjistrave ekonomik APR (të kompanisë / ndërmarrjes së të rinjëve dhe grave, që nuk kanë të regjistruar veprimtarinë e tyre, ku kandidati posedon shumicën e pronësisë).

Mjetet e tërësishme në dispozicion për **grupin e I të shfrytëzuesve janë 4.000.000,00 dinarë** me vlerë mesatare deri më 250.000,00 dinarë për shfrytëzues. Kusht është që shfrytëzuesit të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre - të paktën 15% të shumës totale të kostove të pranueshme të investimit.

Mjetet e tërësishme në dispozicion për **grupin e II të shfrytëzuesve janë 6.000.000,00 dinarë** me vlerë mesatare deri më 550.000,00 dinarë për shfrytëzues. Kusht është që shfrytëzuesit të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre - të paktën 25% të shumës totale të kostove të pranueshme të investimit.

## **DEDIKIMI I MJETEVE TË PAKTHYESHME**

### **Aktivitetet e pranueshme të projekteve**

- Blerja e mjeteve themelore / makineri (mjete pune);
- Adaptimi ose rekonstruimi i hapësirës afariste;
- Blerja e materialit dhe lëndës së parë deri në masën 20% të vlerës neto të projektit.

### **Aktivitetet e projektit të cilat nuk do të financohen**

Mjetet sipas këtij programi nuk mund të shfrytëzohen për:

- Organizimin e lojrave të fatit, lotarive dhe veprimtarive të ngjajshme;
- Prodhimin dhe qarkullimin e çfarëdo prodhimi ose aktiviteti të cilat sipas dispozitave vendore ose me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, konsiderohen të ndaluara,

- Tregëtinë e naftës dhe derivateve të naftës;
- Prodhimin primar bujqësor;
- Çfarëdo lloji i veprimtarisë tregtare dhe hotelierisë.

Përmes programit financohen shpenzimet e blerjes së mjeteve themelore (aseteve fikse), adaptimit ose rekonstruimit të hapësirave afariste, materialit dhe lëndës së parë që janë objekt i Kontratës, e që realizohen pas nënshkrimit të kontratës me Komunën e Preshevës.

Me **mjete themelore** (asete fikse) sipas këtij programi nënkuptohen: objektet (në pajtim me dedikimin e Projektit), sistemet, makinat dhe paisjet e të cilat si shpenzime të arsyetueshme të investimeve pranohen nëse i shfrytëzon kryesisht shfrytëzuesi i përzgjedhur, dhe mund të jenë:

- Investimet në blerjen e makinave dhe paisjeve (në momentin e shpalljes së Konkursit, pajisjet nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 5 vite nga viti i prodhimit dhe duhet të blihen nga subjekti i regjistruar ekonomik);
- Vënia në funksion e hapsirës punuese dhe /ose procesit të punës (që nënkupton adaptimin dhe /ose rekonstruimin e hapsirës prodhuese / punuese nga ana e subjektit të regjistruar ekonomik).

Mjetet e pakthyeshme do të aprovohen për blerjen e të mirave materiale/ shërbimeve për realizimin e idesë së biznesit që do të shpërblehet në kuadër të kësaj gare.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për pjesëmarrje në trajnimin për fillimin/avancimin e biznesit është **4 qershor 2018 deri në ora 14:00**. Aplikacioni duhet të plotësohet në mënyrë elektronike, në të kundërtën nuk do të merret në shqyrtim.

Afati për paraqitjen e aplikacionit në kuadër të fazës së dytë të Programit (Biznes planit) është i kushtëzuar me realizimin e trajnimeve për fillimin/avancimin e biznesit, gjegjësisht 14 ditë pas kryerjes së trajnimeve, ndërsa aplikuesit në fazën e garimit, për të njëjtën do të jenë të njoftuar me kohë.

Për informata më të hollësishme mund t'i drejtoheni Komunës së Preshevës:

Telefoni: 017 669 788

e-mail: s.musliu@presevo.rs

Aplikacionet dorëzohen personalisht nëpërmjet shkresores së komunës së Preshevës ose me post rekomanduese në adresë të Komunës së Preshevës, deri më datën 4 Qershor 2018 ora 14:00, edhe atë nëpërmjet **Shkresores** së Administratës komunale, të cilat do të evidentohen me **numër të veçantë protokoli një nga një**, drejtuar Komisionit për ndarjen e mjeteve stimuluese për zhvillimin e ndermarrësisë lokale në Komunën e Preshevës, me mbishkrimin:

***Pjesëmarrja në Programin e trajnimeve për fillimin/avancimin e biznesit dhe ndarjen e mjeteve të pakthyeshme në sferën e ndermarrësisë së të rinjëve dhe grave.***

***Mos e hapni!***